



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 125, datë 22.12.2023

“PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2024 - 2026 DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2024”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b”, pika 1.3 shkronja “c” nenit 41, pika 1, neni 54, shkronjat “ç” dhe “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 6, shkronjat “ç” dhe “d”, nenit 33, pika 1, nenit 39, pika 1, nenit 40, nenit 41, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, neneve 6, 15, 17 dhe 32, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave ”Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit nr.23, datë 30.07.2018, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore, të ndryshuar, udhëzimit nr. 6 datë 28.02.2023, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”, udhëzimit plotësues nr.21 datë 07.07.2023, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2024 - 2026 si më poshtë vijon:

1.1. Plani i të ardhurave të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2024 - 2026, është në shumat si më poshtë:

Në lekë

Lloji i të ardhurave	Plan 2023	Plan 2024	Plan 2025	Plan 2026
Të ardhura të taksueshme	10,879,500,000	12,914,000,000	12,954,395,000	12,039,017,000
Të ardhura jo tatimore	5,554,000,000	5,338,000,000	5,416,500,000	5,464,935,000
Total të ardhura	16,433,500,000	18,252,000,000	18,370,895,000	17,503,952,000
Transferta e pakushtezuar e përgjithshme	3,008,634,292	3,732,529,694	3,769,854,991	3,807,553,541
Transferta e pakushtezuar sektoriale	1,324,954,914	1,447,328,241	1,447,328,241	1,447,328,241
Total Transferta	4,333,589,206	5,179,857,935	5,217,183,232	5,254,881,782
Të ardhura të mbartura	8,000,000,000	10,000,000,000	5,000,000,000	3,000,000,000
Te ardhura te planifikuara nga donatoret	5,787,444	7,681,704	0	0
Totali	28,772,876,650	33,439,539,639	28,588,078,232	25,758,833,782

1.2. Plani i shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2024 - 2026, është në shumat si më poshtë:

Në

lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plan 2023	Plan 2024	% ne strukturë	Plan 2025	Plan 2026
Shpenzime personeli	7,535,487,444	9,074,742,614	27%	8,709,843,000	8,709,843,000
Shpenzime te tjera operative	8,361,196,095	10,336,038,579	31%	9,884,710,063	9,820,869,845
Shpenzime kapitale	12,876,193,111	14,028,758,446	42%	9,993,525,169	7,228,120,937
TOTALI	28,772,876,650	33,439,539,639	100%	28,588,078,232	25,758,833,782

2. Të miratojë buxhetin e Bashkisë së Tiranës si më poshtë:

2.1. Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës sipas Pasqyrës nr.1, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.2. Të miratojë numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë së Tiranës sipas pasqyrës nr.2 pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.3. Të miratojë detajimin e shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës sipas pasqyrave nr.3, nr.3.1 dhe nr. 3.2, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.4. Të miratojë planin e shpenzimeve kapitale sipas programeve buxhetore sipas pasqyrës nr.4, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.5. Të miratojë limitet e financimeve të huaja në kuadër të projekteve që do të zhvillohen mes Bashkisë së Tiranës dhe Qeverisë Shqiptare sipas pasqyrës nr.5, pjesë përbërëse të këtij vendimi.

2.6. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit të kryejë avancim të fondeve mujore sipas realizimit të të ardhurave për vitin 2024.

3. Të miratojë Kalendarin e përgatitjes së Buxhetit të vitit 2025 si dhe të PBA 2025 - 2027.

4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik, Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme e Mjedisit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njërive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Teknologjisë së Informacionit dhe të të Dhënave, Drejtoria e Përgjithshme e Medias dhe Komunikimit, si dhe institucionet në varësi të Bashkisë Tiranë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2024.

K R Y E T A R

ROMINA KUKO